

Akt Themelimi

I Shoqerise Tregtare “ERT-BRUNO” SH.P.K.

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit”, te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per shoqerite tregtare” dhe te ligjit Nr.131/2015 per “Qendren Kombetare te Biznesit” dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare, me vullnetin e tyre te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi, Ne, themeluesit Z.Carmine Bruno, me nr.Karte identiteti CA52593GR, lindur me 10.04.1990 dhe banues ne Via Cima Carega, N.24 I.2 Lavagno (VR) Itali dhe Z.Erti Okshtuni, i datelindjes 20.03.1993, banues ne Kavaje, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “ERT-BRUNO” SH.P.K. me akt themelimi si vijon :

Formulimi

Neni 1

Sot me date 26/10/2021, formohet shoqeria tregtare private e quajtur “ERT-BRUNO” SH.P.K. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

Selia e Shoqerise

Neni 2

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Kryemedhenj, Njesia Administrative Golem, Bashkia Kavaje, ndodhur ne zonen kadastrale nr.2291, pasuria me numer 304/30+1-12, volumi 33, faqe 200, me sip.50m2.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese dhe ortakeve te saj.

Objekti i Veprimtarise

Neni 3

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Ndertime civile, punime dheu, ndertime rruge .Rikonstruksion godinash,civile e ekonomike,veshje fasadash etj. Stabilizim, permiresim te rreshqitjeve, punime rreshqitje. Stabilizim, rehabilitim I segmenteve rrugore,shfrytezim dhe transport te materialeve te nxjerra, inerteve, lendeve minerare etj, si dhe shitjen brenda vendit apo eksportin e tyre . Prodhimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve industriale; import dhe eksport të makinave të prodhuara dhe pajisjeve te pjesëve të këmbimit: blerjen e të gjitha llojeve te mallrave, me qëllim për të shitur ato në formën e tyre origjinale ose te transformuara, importin dhe eksportin e tyre, si dhe riekportin e tyre pas perfundimit te procesit te prodhimit. Aktivitet ne fushen e turizmit, shendetesise, hoteleri-restorante, agjensi sherbimesh per te gjitha llojet, perfaqesi tregtare, prodhimin dhe tregtimin e cdo lloj produkti industrial ,bujqesor e blegtoral dhe

per kafshe, agjensi mobilare dhe imobilare, si dhe cdo lloj aktiviteti prodhues dhe tregtar qe lejohet nga ligji.

Kohezgjatja e Shoqerise

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar. Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkak.

Kapitali i Shoqerise

Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqind mijë) Lekë.

Kapitali i Shoqerise eshte i ndare ne 2 pjese (kuota), me vlere 50.000 (pesedhjete mije) leke secili.

Ortaku Carmine Bruno: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë 50.000 (pesedhjete mije) leke, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku Erti Okshtuni: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë 50.000 (pesedhjete mije) leke, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Drejtimi i Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj Z.Erti Okshtuni, i cili do te jete dhe perfaqesuesi ligjor i saj. Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posaçme.

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve.

Neni 8

Ortaket kane te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale.

Kane te drejte te caktoje financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtojne persona te tjere si ortake.

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Kavaje.

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "ERT-BRUNO" SH.P.K.

Akti i themelimit nenshkruset rregullisht nga ortaket.

Ortaket themelues:

CARMINE BRUNO

CARMINE BRUNO

ERTI OKSHTUNI

ERTI OKSHTUNI

